

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hitaj takimet me strukturat në qarqet e vendit: Policia e Shtetit intensifikon masat kundër krimit për rritjen e sigurisë publike
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/hita-takim-ne-shkoder-kerkon-rezultate-me-te-larta-ne-goditjen-e-grupeve-i584792
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	8 shtator 2026, 16:29:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 16:30:07 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	693589c2217fa5d24be5275ce6ab0f1c44e346fc001de52c3afd041735647edb
TEKSTI	973d2e3ce1595166204d4bec00a68fb068106753025bc30871be252320f4216a
PAMJA	bcdeca775ba6b1b48afa5f589d98a72a2cd93f80ebee303329f5a1ab34d03574

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b2c8498d3dbee78d3ddf714b44d938daea1cb2a1083aec59b1be6cf6353d2050
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b2c8498d3dbee78d3ddf714b44d938daea1cb2a1083aec59b1be6cf6353d2050>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e Putin dhe Trump Hasin 1 ore në telefon. Kremli: Nuk kemi plane të sulmojmë Europen! Londra dhe Berlina turnizojnë Kievin me raketa PatriotDeputetet e PD-së braktisin sallën - Kuvendi voto fundit

Hitaj takimet me strukturat në qarqet e vendit: Policia e Shtetit intensifikon masat kundër krimit për rritjen e sigurisë publike

8 Shtator 2026, 18:30Kronika TEMA



 Hitaj takimet me strukturat në qarqet e vendit: Policia e Shtetit

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Skender Hita, mban takime me strukturat në Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër dhe Lezhë

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skender Hita, ka vijuar takimet me strukturat vendore dhe ato të kufirit në në kuadër të intensifikimit të masave për sundimin e ligjit në territor.

Takimet u zhvilluan në Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër dhe Lezhë, me fokus kryesor intensifikimin e masave për parandalimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale, rritjen e parametrave të sigurisë publike dhe rrugore, sigurinë në shkolla, si dhe etikën dhe shërbimin ndaj qytetarëve.

Gjatë takimeve, Drejtori Hita u ndal te situata kriminale, me theks te krimet e rënda, kultivimi dhe trafikimi i narkotikëve.

Ai kërkoi angazhim maksimal të Policisë Kriminale për sigurimin e informacionit dhe veprim të menjëhershëm ndaj elementeve që qarkullojnë me armë zjarri, armë të ftohta, lëndë eksplozive, lëndë narkotike, si dhe ndaj atyre që kultivojnë bimë narkotike.

“Të punohet me hetime proaktive për të evidentuar dhe goditur grupet kriminale dhe të intensifikohet puna hetimore për zbardhjen e ngjarjeve kriminale të ndodhura më parë,” theksoi Hita, duke nënvizuar se situata duhet të ndryshojë menjëherë si për krimet e rënda, ashtu edhe për kultivimin e kanabisit.

Një tjetër temë e rëndësishme ishte siguria rrugore. Pavarësisht angazhimit maksimal të Policisë Rrugore me mjetet inteligjente në dispozicion, çdo ditë konstatohet një numër i madh shkeljesh, të cilat mbeten burim rreziku për aksidente.

Me nisjen e vitit të ri shkollor për pak ditë, Drejtori i Përgjithshëm u ndal gjatë te siguria në shkolla. Ai kërkoi që Policia e Shtetit të bëjë gjithçka të mundur për mbrojtjen e nxënësve, duke përfshirë sigurinë fizike, sigurinë ushqimore në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU), sigurinë kibernetike dhe atë rrugore, me qëllim që nxënësit të ndihen të mbrojtur dhe të sigurt.

Etika në komunikim, zbatimi i ligjshmërisë dhe ndjekja dinamike e adresimeve të qytetarëve ishin gjithashtu tema të diskutimit.

Drejtori Hita kërkoi më shumë angazhim nga shefat e komisariateve dhe drejtorët e qarqeve, duke theksuar se ata duhet të presin qytetarët që kanë probleme, t’ua hapin telefonin dhe t’u japin zgjidhje shqetësimeve që janë në kompetencë të Policisë.

Në takimet me Policinë Kufitare, u kërkua etikë në komunikim në pikat e kalimit kufitar, luftë pa kompromis kundër krimeve kufitare, marrëdhënie të forta bashkëpunimi me homologët ndërkombëtarë dhe koordinim të veprimeve për eliminimin e radhëve gjatë flukseve.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Kapet "mat" në makinë duke ndarë mallin, arrestohet 27-vjeçari që shpërndante drogë në Tiranë, si tentoi t'i ikte policisë](#)

16:30 Kronika

[Ilir Meta nuk heq dorë nga kërkesa për të dalë nga qelia, i drejtohet Gjykatës së Lartë për zbutjen e masës](#)

16:05 Kronika / 3 komente

[Spanja sekuestron mbi 1.2 ton kokainë të fshehur në një ngarkesë me arra kokosi](#)

16:00 Kronika

[Lamallari: Rishikojmë kriterin e moshës për pranimin në shërbimin zjarrfikës](#)

14:40 Kronika

[Dhoma e Avokatisë shpall bojkot pa afat të gjyqeve në GJKKO, deri në pezullimin e rregullores së re](#)

14:18 Kronika / 4 komente

[Rregullorja që kufizon mediat dhe frika e Erion Banit nga transparenca](#)

13:45 Kronika / 11 komente

[Ndalimi i celularëve në seanca, Maks Haxhia: Nuk kemi marrë asnjë reagim nga GJKKO](#)

13:40 Kronika / 2 komente

[Tragjedi në Tropojë, humbin jetën pas rënies në kontakt me rrymën elektrike 2 punonjës të Bashkisë, 2 të tjerë plagosen rëndë](#)

13:35 Kronika / 3 komente

[Tjetër ngjarje e rëndë, Hita zhvillon takim me strukturat e Policisë Shkodër](#)

13:30 Kronika / 1 koment

[Në kërkim nga Interpol Tirana për vjedhje me armë, arrestohet shqiptari në Greqi](#)

13:00 Kronika

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javen e fundit

[Përplasja mes biznesmenëve për pronën në Palasë, Filip Ça...](#)

10:10 Sociale / 24 komente

[Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...](#)

14:15 Politika / 30 komente

[Përplasja mes biznesmenëve për pronën në Palasë, reagon K...](#)

21:50 Kronika / 6 komente

[Debati për pagat e magistratëve, Olsian Çela thërret mbl...](#)

22:05 Kronika / 29 komente

[Kokalari shpërthen ndaj Berishës nga SHBA: Vetëm paratë e...](#)

13:38 Politika / 24 komente

Blog Tema

[Përse dështoi Reforma në Drejtësi](#)

17:10 Blog

[Pelegrinazhi amerikan i Berishës i duhet vetëm Berishës](#)

16:24 Blog

[Gjaku blu i magistratëve dhe çirakët e republikës](#)

15:33 Blog / 13 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.